

P Z A P
I P Ž P



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 443/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhammed Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak se në librat e votuesve nuk kanë figuruar votues shqiptar, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet poshtë ankesa si e palejuar e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik AKR, me te cilën pretendohet se në fshatrat Bistricë, Kushtovë dhe Ceraga, në librat e votuesve kanë figuruar vetëm votuesit serb si pasojë e kësaj votuesit shqiptar është dashtë të votojnë vetëm më kusht, që është në kundërshtim me nenin 64.1 të LZP-së.
Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, parasheh:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji.

Përgjegjësit dhe Funksionet e KQZ-së

Neni 64 i LZP-së parasheh:

64.1 KQZ-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, nen 6 paragrafi 4 parashesh:

Panellet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie .

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e palejuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë nuk janë nën juridikcionin e PZAP-it, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa

A nr. 443/2010 më datën 13.12.2010.

